

Republika e Kosovës - Republika Kosova
 Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
 Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
 Uprava za Opšte Administrativne Poslove

Nr./Br. 01/2019
 Data/Datum 09.11.2019

Gjakovë-Djakovica-Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës
 01 Nr. _____ /2019
 Dt.31.10.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 1. Paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme: në mbledhjen e mbajtur me dt.31.10.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm në pronat Komunale, parcelat me numër P-70705037-01332-4, P-70705037-01333-1, P-70705037-01332-2 Z.K Jahoc, me sipërfaqe prej 2.51.94 ha, për varrezat e fshati Jahoc, e miratoi këtë:

V e n d i m
Për Shpalljen e interesit publik .

1. Shpallet Interesi i përgjithshëm në pronat Komunale, parcelat me numër P-70705037-01332-4, P-70705037-01333-1, P-70705037-01332-2 Z.K Jahoc, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.51.94 ha në pronësi të Komunës së Gjakovës .
2. Qëllimi i shpalljes së Interesit të përgjithshëm në parcelën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet për caktimin e lokacionit për vendosjen e varrezave të fshatit Jahoc .
3. Obligohen Organet e Administratës Komunale që ti ndjekin të gjitha procedura sipas legjislacionit në fuqi për realizimin e këtij vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

5. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Drejtorisë për Shërbime Publike .
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
 Anton Shala